



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.412/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli kryesues, Hajriz Hoti dhe Ramush Bardiqi -anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, Nisma Social Demokrate, Nisma, Konservatoret dhe Intelektualet me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.412/2025 e datës 06.02.2025

II. Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, Nisma SocialDemokrate, Nisma, Konservatoret dhe Intelektualet me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 3,000.00 (tremijë) euro.

III. Detyrohet Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, Nisma Social Demokrate, Nisma, Konservatoret dhe Intelektualet me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 06.02.2025 PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më 6 Shkurt 2025, Kryetari i komunës së Suharekës, njëherit kandidat për deputet nga koalicioni AAK-NISMA, Bali Muharremaj, ka vizituar dhe ka zhvilluar një takim me punonjës të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Rexhep Kuçi", në Suharekë dhe gjithashtu në Urgjencën e kësaj QKMF-je, dhe se kjo është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e

Përgjithshme në Kosovë si dhe Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar. Për qëllime elektorale dhe me qëllim të promovimit të vetës dhe subjektit të tij politik dhe me qëllim të inkurajimit dhe përfitimit nga nëpunësit publik, kandidati për deputet realizon vizita në institucione publike të shëndetësisë në kundërshtim me LZP-në.Parashtruesi i ankeses ka bashkangjitur si provë postimin në Facebook <https://www.facebook.com/share/p/1ADNVArKsn/?mibextid=—ëëXlfr> dhe fotografitë bashkëngjitur.

Në përgjigjen në ankesë të datës 07.02.2025, të Koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, Nisma SocialDemokrate, Nisma, Konservatorët dhe Intelektualet, theksohet se është fakt notor që z. Muharremaj mban pozitën e kryetarit të Komunës së Suharekës. Njësoj si para fushatës, ai poston fotografi nga QKMF, të cilat janë ndërtuar gjatë mandatit të tij, duke krijuar një lidhje të tërthortë me punën e kësaj qendre. Prandaj në asnjë mënyrë nuk mund të nxirren fotot nga konteksti, siç pretendon subjekti ankues, pasi nuk është hera e parë që z. Muharremaj ndërmerr një veprim të tillë. Një praktikë e tillë është përsëritur në mënyrë të vazhdueshme në cilësinë e kryetarit të komunës. Por një veprim i tillë është kryer edhe nga z. Albin Kurti me datë 07.02.2025, ka publikuar një postim në rrjetin social Facebook, ku, së bashku me pjesëtarë të Policisë së Kosovës, ka përruar nënstationin policor në Leshak të Leposaviqit. Ky fakt vërtetohet edhe nga fotot e bashkangjitura në këtë përgjigje, megjithatë, një veprim i tillë nuk është kontestuar, pasi është kryer në cilësinë e Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Në mënyrë të ngjashme, veprimi i z. Muharremaj, i cili ka realizuar vizitën në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Suharekës, nuk mund të cilësohet ndryshe. Prandaj nuk ka asnjë mundësi që është konsumuar ndonjë shkelje të dispozitave të Nenit 36, par. 1, 2 dhe 3 të LZP-së dhe Nenit 4, par. 1 të Rregullores Zgjedhore 07/2024.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

Ankesa është bazuar

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore dhe përgjigjen në ankesë, ka gjetur se postimi i fotografive në rrjetin social facebook, nga kandidati për deputet nga Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, Nisma SocialDemokrate, Nisma, Konservatorët dhe Intelektualet, Bali Muharremaj, është vërtetuar se se ka bërë fushatë duke vizituar dhe zhvilluar një takim me punonjës të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare. Nga prova materiale e bashkangjitur ankesës, së Subjektit Politik LVV, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se nga ana e kandidatit për deputet nga radhët e Koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, Nisma SocialDemokrate, Nisma, Konservatorët dhe Intelektualet, është shkelur dispozita ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme LZP, konkretisht neni 36 paragrafi 1, 2, dhe 3, i cili percakton: *“1. Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të*

ndonjë subjekti politik në zgjedhje 2. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga nëpunës i publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik 3. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të subjekteve politike në zgjedhje, burime ose resurse të institucioneve apo organeve publike në nivel qendror ose lokal, apo çdo lloj institucioni tjetër publik” Përveç kësaj, me nenin 5 par 2, pika 2.1 Rregulla Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, është përcaktuar se: Të punësuarit në institucionet shtetërore dhe publike, gjatë orarit të rregullt të punës, përveç kandidatëve të certifikuar, të cilët pezullojnë vendin e punës” PZAP vlerëson se kandidati për deputet i koalicionit të sipër theksuar ka shkel rregullat e sipërcituara kjo pasi që ka përdorë objektin publik dhe të punësuarit e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare me qëllim të promovimit të kandidaturës së tij për deputet.

Gjithashtu Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor të kësaj natyre. Kjo konsiston në faktin se Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, Nisma Social Demokrate, Nisma, Konservatorët dhe Intelektualet, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e fotografisë në rrjetin social facebook nga kandidati i Koalicionit, për fushatë zgjedhore ku është shfrytëzuar objekti publik dhe takimi me punonjës shëndetësor, është në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 36 paragrafi 1, 2, dhe 3 të LZP-së.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 neni paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.412/2025 më datën 09.02.2025

Kryesues i Panelit
Kujtim Pasuli

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.